



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.06.2024)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:05 dhe mbaroi në orën 15:13.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>3. Irena Plaku</b>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>4. Ridvan Hado</b>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>5. Alban Toro</b>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>6. Emona Muçi</b>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>7. Markelian Koça</b>  | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami; Gjithashtu nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Gentiana Muçaj dhe znj. Fatmira Luli.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.*

*3. Staf administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen plenare të datës 03.06.2024, me rend dite: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë, sot ne si Komision kemi paraqitur relacionin e radhës që ka për objekt “Për caktim gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”. Kërkesa faktikisht e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është protokolluar më datë 31.05.2024 dhe arsyeja e kërimit që ne kemi bërë për t’u zhvilluar mbledhja për caktim gjyqtari ditën e sotme, lidhet me faktin se një nga këto tre kërkesa me natyrë penale ka karakter urgjent, pasi një nga të pandehurit që gjykohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat për akuzën e vrasjes me dashje mbetur në tentativë, sipas njoftimit të sjellë nga zëvendëskryetarja në detyrë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, i kanë mbetur afatet e paraburgimit të pakonsumuara deri në datë 21.06.2024 (pra 21 qershor i vitit 2024 i përfundojnë afatet e paraburgimit një të pandehuri që gjykohet në Berat për akuzën e vrasjes me dashje të mbetur në tentativë). Kjo është edhe

arsyeja pse ne kemi kërkuar zhvillimin e mbledhjes për të shqyrtuar kërkesat e plotësimit të trupit gjykues të paraqitura nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Pa humbur kohë unë po vijoj me prezantimin e relacionit, por fillimisht e ndjeva si të nevojshme për të prezantuar arsyet e urgjencës së shqyrtimit të relacionit.

Deri më datë 03.06.2024, pranë KLGJ-së, është paraqitur për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, kërkesa të parashtruara me shkrim nga Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas të dhënave të mëposhtme:

Bëhet fjalë për e kërkesa me natyrë penale. Kërkesa e parë ka për objekt akuze veprën penale “Vjedhje me dhunë, kryer në bashkëpunim” dhe numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet për plotësimin e trupit gjykues është 1. Numri i kërkesës është 608 dhe numri i çështjes është 338/58. Në këtë rast kërkohet caktimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes gjyqësore në themel për akuzën e përmendur më lart. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}.

Kërkesa e dytë e cila është ajo kërkesë të cilën unë e përmenda më parë, pra kërkesa me natyrë urgjente, i referohet objektit të akuzës neni 76 i Kodit Penal në lidhje me nenin 22 është “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë”. Edhe në këtë rast kërkohet plotësimi i trupit gjykues me një gjyqtar nga gjykata të tjera. Numri i kërkesës është 605 dhe numri i çështjes është 338/70. Në këtë rast trupi gjykues për plotësim është i përbërë nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Kërkohet caktimi i një gjyqtari për të plotësuar trupin gjykues për këtë çështje penale që gjykohet me tre gjyqtarë.

Kërkesa e tretë penale ka për objekt akuze veprën penale të “Vrasjes me dashje të mbetur në tentativë”, të parashikuar nga neni 76 dhe 22 i Kodit Penal. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 1. Numri i kërkesës është 66 (606) dhe numri i çështjes është 267. Kërkohet caktimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes së themelit. Trupi aktualisht gjykues i paplotësuar përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}.

Në vijim të relacionit ne si Komision vlerësojmë se zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit bëhen të pamundura për t’u aplikuar në rastin konkret. Ndodhur në këto kushte, ne si Komision propozojmë që të vihet në zbatim mekanizimi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

gjqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Ky propozim mbështetet në nenin 170, paragrafi i parë i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në vendimin e hartuar për këtë qëllim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”.

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të vendimit të KLGJ-së të përmendur më lart, si dhe në zbatim të paragrafit V, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon mbledhjes së sotme:

Gjykata nga ku duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e tre çështjeve gjyqësore të veçanta penale, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 (tre) çështjeve gjyqësore të veçanta penale të jetë 3 (tre). Pra për çdo çështje të caktohet nga një gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (pjesa e seksionit penal).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Për 3 (tre) çështje, për të cilat kërkohet respektivisht nga 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhen me short 3 (tre) të tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, seksioni penal.

Përfundimet nga shorti:

Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, konkretisht: znj. {...}.

Këto janë propozimet e Komisionit të bëra në mbledhje. Nëse anëtarët kanë pyetje ose komente, ne jemi të gatshëm për të ofruar bashkëpunimin tonë.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse kanë diskutime për sa u parashtrua nga relatori z. Kurushi.

Meqenëse nuk ka diskutime, të vijohet me hedhjen e shortit nga administrata.

*Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën nr. 605, gjyqtar i përzgjedhur Genci Busho.

Për kërkesën nr. 606, gjyqtare e përzgjedhur Miranda Nakaj.

Për kërkesën nr. 604, gjyqtar i përzgjedhur Noel Veizi.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Me hedhjen e shortit e deklaroj të mbyllur mbledhjen e ditës së sotme.

Javë të mbarë!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**